

KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES

NJOFTIM PER INFORMATA SHTESE

ose

PERMIRESIM I GABIMIT

Sipas Nenit 53 të Ligjit Nr. Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92

Punë

Furnizim

Shërbime

[Përkujtese: Nëse ndonjë përmirësim i gabimit ose informacion shtese shpije ne një ndryshim rrënjësor të kushteve të parashikuara në njoftimin origjinal te kontratës me një influencë mbi parimin e trajtimit të barabartë dhe në objektivin e prokurimit konkurrues, do të jetë e nevojshme zgjatja e afateve fillimisht te parapara]

Data e përgatitjes te këtij njoftimi: 15.02.2023

Nr i Prokurimit	616-23-1001-2-1-1
Nr i brendshëm	

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip



Serbisht



Anglisht



NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtar: KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES		
Adresa Postare: TREPQES NR.2		
Qyteti: PRISHTINË	Kodi postar: -	Vendi: Kosovë
Personi kontaktues: Flamur Sallahu	Telefoni: 038 230 900 038 244 613	
Email: flamur.sallahu@rks-gov.net prokurimi.prishtine@rks-gov.net	Faksi:	
Adresa e Internetit (nëse aplikohet):	https://kk.rks-gov.net/prishtine/	

NENI II: LËNDA E KONTRATËS

II.1) PËRSHKRIMI

II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: (ashtu siç është përcaktuar ne njoftimin origjinal te kontratës)

Pastrimi i objekteve për shkollat fillore në Komunë të Prishtinës

II.1.2) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës (ashtu siç është përcaktuar ne njoftimin origjinal te kontratës)

Pastrimi i objekteve për shkollat fillore në Komunë të Prishtinës

II.1.3) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP): (ashtu siç është përcaktuar ne njoftimin origjinal te kontratës)

93000000-8

NENI III: PROCEDURA

III.1) LLOJI I PROCEDURËS

III.1.1) Lloji i procedurës (ashtu siç është përcaktuar ne njoftimin origjinal te kontratës)

E hapur

E kufizuar

Konkurruese me negociata

Kuotim i çmimit

III.2) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

III.2.1) Data e publikimit të njoftimit origjinal të kontratës:

NENI IV: INFORMACIONET PLOTËSUESE

IV.1) KY NJOFTIM PERFSHINE

Përmirësim

Informata shtesë

Njoftim për kontrate

Njoftim për dhënie kontrate

IV.2) INFORMACIONI QE DUHET TE PERMIRESOHER OSE TE SHTOHET (nëse aplikohet; te specifikohet vendi i tekstit ose datat te cilat duhet te përmirësohen apo te shtohen, ju lutem gjithmonë ofroni nenet përkatëse & numrin e paragrafit te njoftimit origjinal)

IV.2.1) Modifikimi i informatave
origjinale të dorëzuara nga
Autoriteti Kontraktues

Publikimi në webfaqen e KRPP-së
nuk është në përputhje me informatat
origjinale të dorëzuara nga Autoriteti
Kontraktues

Të dyja

IV.2.2) Në njoftimin origjinal

Në dokumentet e tenderit

Të dyja

IV.2.3) Teksti i cili duhet të përmirësohet/shtohet në njoftimin origjinal (nëse aplikohet)

Vendi i tekstit i cili duhet të
modifikohet:

Në vend të:

Është :

<p>Kërkesat e përshtatshmërisë</p>		<p>1. Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr. 04 L-42. LPP mund të shkarkohet nga http://krpp.rksgov.net, 1. Deklaratën nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë Neni 65 i Ligjit Nr. 04 L-042 , Plotësimi i Aneksit Nr. 2 te Dosjes se Tenderit 2. Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit. Kërkohej kopja vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërbllim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. 3. Një vërtetim nga Gjykata qe vërteton se a. Operatori ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluar nuk a është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale; dhe b. Operatori ekonomik nuk është ne falimentim ose nën administrim te dhunshëm gjyqësore. Për piken (a) dhe (b) Kërkohej origjinali vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërbllim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Dështimi i Operatorit Ekonomik qe është propozuar qe te shpërblehet me kontrate te sjelle dokumentet te kërkuara ne</p>

	<p>piken, 2 dhe 3 i jep të drejtë Autoritetit Kontraktues qe ofertën ta refuzoj, te konfiskoj sigurimin e tenderit nëse e njëjta është kërkuar, të inicioj procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-se dhe te vazhdoj me shpërblim te kontratës me Operatorin Ekonomik qe është listuar ne vendin e dyte.</p>
Përshtatshmëria profesionale	<p>1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit për ushtrimin e veprimtarisë,</p> <p>1. Kopja e Certifikatës se biznesit</p>
Përshtatshmëria profesionale	<p>2. Certifikata e numrit fiskal, 2. Kopja e Certifikatës se numrit fiskal</p>
Kapaciteti ekonomik dhe financiar	<p>1. Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit fiskale ka qenë prej jo më pak se 900.000,00 Euro, 1.</p> <p>Deklaratat e dorëzuara ne Administratën Tatimore te Kosovës apo Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve te menaxhimit te certifikuara nga një firme e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur</p>
Kapaciteti teknik dhe profesional	<p>1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së njëjtë pastrim në vlerë minimale prej 800.000,00 Euro, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë)., 1.</p> <p>Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 7 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose</p>

<p>Kapaciteti teknik dhe profesional</p>	<p>certifikatat për kryerje të shërbimeve.</p> <p>2. a) OE duhet të deklarohet se do të punesoj minimumi 77 puntore nga lista e Autoritetit Kontraktues, ndërsa për kryerjen e këtyre shërbimeve duhet të shtoj edhe 38 puntor nga personeli i tij dhe 6 punëtor mobil, gjithsej 118 puntorë. b) OE duhet të deklarohet se do të paguan të gjithë punëtorët pagat e njëjta me punëtorët e këtij sektori neto prej 250.00 euro. c) Analiza financiare për pagën baze 250€ neto të pasqyruara me të gjitha obligimet ligjore sipas Ligjit të Punës Nr.03 L-212 si dhe ATK-se, 2. a), b) dhe c) Të dëshmohet me deklarate origjinale e nënshkruar dhe e vulosur nga OE si dhe analizën financiare të detajuar (origjinal).</p>
<p>Kapaciteti teknik dhe profesional</p>	<p>3. Operatori Ekonomik duhet të posedoj minimumin (5) punëtor(staff) të certifikuar për siguri dhe shëndet në punë në përputhshmeri me Ligjin Nr.04 L-161 sipas organogramit të kompanisë., 3. Të dëshmohet me kopje të certifikatave valide dhe organogrami të kompanisë (kopje).</p>
<p>Kapaciteti teknik dhe profesional</p>	<p>4. a) Operatori Ekonomik duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare të menaxhimit të cilësive në lëmin e pastrimit të objekteve, me ISO Certifikate 9001 2015 (valide). b) Operatori duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, në lëmin e pastrimit të objekteve OHSAS Certifikate 45001 2018 (valide). c) Operatori duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare të menaxhimit të mjedisit, në lëmin e pastrimit të objekteve ISO Certifikate 14001 2018 (valide). Iso standard për</p>

	menagjimin e sigurisë dhe shëndetit në punë., Per piken (a), (b), (c); Te deshmohet me certifikatat perkatase per secilen (kopje). SHENIM ME RENDESI - Certifikatat duhet te posedojne linkun e faqes per verifikim online te validitetit te certifikatave!
Kapaciteti teknik dhe profesional	5. Operator Ekonomik duhet te deklarohet se materialet e perdorura janë ekologjike dhe te atestuara, 5. Te deshmohet me deklarate origjinale e nënshkruar dhe e vulosur nga OE kurse kerkohen edhe MSDS dhe etiketa e produktit (kopje).
Kapaciteti teknik dhe profesional	6. Operatori Ekonomik duhet te kete raportin e vleresimit te riskut te kompanise leshuar nga; a) oraganet (institucioni) pergjegjese ose, b) nga ndonje kompani e licencuar per vleresim te riskut te kompanive, 6. Te deshmohet; a) me dokument ose raport, b) me license nga kompani te licensuar (kopje).
Kapaciteti teknik dhe profesional	7. Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimetet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit Pasjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 8 te DT., 7. Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet qe nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për automjetet qe regjistrohen. Ne rastet kur OE ka marveshje per shfrytezimin, OE duhet te dorezoj edhe marveshjen per shfrytezim. Poashtu kontratat për pajisjet.

----- (Shto nenin IV.2.3 sa here qe keni nevojë) -----